

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 573 REP.
NR. 7% KOL.

PULLE TAKSE



KONTRATE SHIT-BLERJE AKSIONESH

Ne Tirane, sot me date 6.10.2007 (dymijë e pese), ne zyrën noteriale rruga Reshit Çollaku, Pall. Shallvare, nr. 41, para meje noterit Dusho Dusha, midis palëve te mëposhtme u lidh kjo kontrate shitblerje aksionesh:

SHITËSIT:

- Z. Grigor Joti, shtetas shqiptar, lindur me 13.02.1956, ne Korçe dhe banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes nr.EV 081674
- Z. Gezim Dobi, shtetas shqiptar, lindur ne Gjirokaster me 09.06.1953 banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes me numer 0706341,

BLERËS:

Z.Frederik Prodani, shtetas shqiptar, lindur me 02.09.1958, ne Durres dhe banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes nr.EV Z 0106559,

OBJEKTI: Shitja e 11,710 (njembehjetmije e shtatëqindedhjetë) cope aksioneve te Shoqërisë InfoSoft Office sh.a nga ana e aksionerëve Grigor Joti dhe Gezim Dobi e ndare perkatesisht ne 7,026 aksione dhe 4,684 aksione dhe blerja e tyre nga Z. Frederik Prodani.


PËRMBAJTJA E KONTRATËS:

Shoqëria InfoSoft Office sh.a, është regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Parë Tiranë me Vendimin nr. 7107 dt. 30.09.1993 dhe ka një kapital themeltar te regjistruar prej 73,193,000 (shtatedhjetetremilion e njeqindenentedhjetetremije) leke.

Me vendim te Asamblesë se Jashtëzakonshme te Shoqërisë, është vendosur ne mënyre unanime nga te gjithë aksioneret e shoqërisë miratimi i shitjes se pjesëve zotëruese te aksionereve te saj si me poshtë:

- Z. Grigor Joti do te shesë nga pjesa e tij zotëruese ne kapitalin aksioner te shoqërisë 7,026 cope aksione me vlere nominale te një aksioni 1,000 (njëmijë) leke.

Z. Grigor Joti, është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij te lire dhe te plote Blerësit 7,026 cope aksione nga aksionet e tij zotëruese ne kapitalin aksioner te shoqërisë InfoSoft Office sh.a.



Nga ana e vet, Blerësi është plotësisht dakord që të blejë 7,026 cope aksione nga pjesa që aksioneri Grigor Joti zotëron në shoqërinë InfoSoft Office sh.a.

- Z. Gezim Dobi do të shesë nga pjesa e tij zotëruese në kapitalin aksioner të shoqërisë 4,684 cope aksione me vlerë nominale të një aksioni 1,000 (njëmijë) leke.

Z. Gezim Dobi është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lire dhe të plote Blerësit 4,684 cope aksione nga aksionet e tij zotëruese në kapitalin aksioner të shoqërisë InfoSoft Office sh.a.

Nga ana e vet Blerësi është plotësisht dakord që të blejë 4,684 cope aksione nga pjesa që aksioneri Gezim Dobi zotëron në shoqërinë InfoSoft Office sh.a.

ÇMIMI I SHITJES SE AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS:

- Vlera e shitjes së aksioneve nga Z. Grigor Joti, do të jetë e barabartë me 7,026,000 (shtatë milion e njëzetë gjashtë mijë) leke, vlerë kjo me të cilën është vlerësuar paketa e 7,026 cope aksioneve të shitura nga ana e aksionerit të kësaj shoqërie Z. Grigor Joti, për të cilën është rënë dakord nga ana e palës blerëse.

Pagesa në shumën e mësipërme është bërë jashtë zyrës noteriale dhe në mënyrën e pagesës me bankë.

- Vlera e shitjes së aksioneve nga Z. Gezim Dobi, do të jetë e barabartë me 4,684,000 (katër milion e gjashtëqinda) leke, vlerë kjo me të cilën është vlerësuar paketa e 4,684 cope aksioneve të shitura nga ana e aksionerit të kësaj shoqërie Z. Gezim Dobi, për të cilën është rënë dakord nga ana e palës blerëse.

Pagesa në shumën e mësipërme është bërë jashtë zyrës noteriale dhe në mënyrën e pagesës me bankë.

MËNYRA E KALIMIT TE PRONËSISË SE AKSIONEVE:

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitësi Grigor Joti, aksioner i shoqërisë InfoSoft Office sh.a, humbet pronësinë mbi 7,026 cope aksione të pjesës së tij takuese në kapitalin aksioner të shoqërisë së mësipërme.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitësi Gezim Dobi, aksioner i shoqërisë InfoSoft Office sh.a, humbet pronësinë mbi 4,684 cope aksione të pjesës së tij takuese në kapitalin aksioner të shoqërisë së mësipërme.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Blerësi Frederik Prodani bëhet pronar i 11,710 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqindëdhjetë) cope aksioneve të kapitalit aksioner të shoqërisë.





Kështu, me përfundimin e këtij transaksioni shitblerjeje, gjendja e zotërimit të aksioneve nga ana e palëve në këtë kontratë në shoqërinë InfoSoft Office sh.a rezultojnë si më poshtë:

Blerësi Z. Frederik Prodani do të zotërojë 11,710 (njemëdhjetmijë e shtatëqindëdhjetë) copë aksione ose 16% të kapitalit aksioner të shoqërisë.

Shitësi Z. Gezim Dobi, do të zotërojë 24,592 (njëzetkatërmijë e pesëqindëdhjetë) copë aksione ose 33,6% të kapitalit aksioner të shoqërisë.

Shitësi Z. Grigor Joti, do të zotërojë 36,888 (tridhjetëgjashtëmijë e tetëqindëdhjetë) copë aksione ose 50,4 % të kapitalit aksioner të shoqërisë.

KLAUZOLA SHITESË TE KONTRATËS:

Kontrata hartohet në 6 kopje të barabarta, nga të cilat nga një e mbajnë palët, një kopje dorëzohet në Zyrën e Rregjistrimit Tregtar, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë dhe një kopje pranë noterit ku ajo u redaktua.

Termat e kontratës pasi u reduktuan prej meje noterit iu bënë të njohura palëve kontraktuese, të cilët e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plote në praninë time.

Shitësit

Grigor Joti

Gezim Dobi

Blerësi

Frederik Prodani

